



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03, prill 2019), të nenit 29, të Rregullores nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme, dhe në bazë të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

## V E N D I M

### **PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 01.463/01-27259/21, TË DT. 11.02.2021, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01.463/01-27259/21, i dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim - ndryshimi nënkupton, si në vijim:
  - I. Ndryshohet pika II e vendimit, shtohen pjesët e parcelave kadastrale: nr. 997-4, me sipërfaqe 310 m<sup>2</sup> dhe nr. 997-5, me sipërfaqe 212 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Matiçan, në pronësi të Besnik (Feti) Lecit, të cilat do të këmbehen me pjesën e parcelës nr. 2669- 0, me sipërfaqe prej 215 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.
- III. Propozimi për inicimin e plotësim-ndryshimit të Vendimit të cekur në pikën II, është bërë pasi që Vendimi nr. 01.463/01-27259/21, dt. 11.02.2021, nuk mund të ekzekutohet për arsye se parcela nr. 996-0, me sipërfaqe 215 m<sup>2</sup>, në pronësi të Besnik Lecit, pas vlerësimit nga Ministria e Financave, Departamenti i Vlerësimit nuk e mbulon sipërfaqen prej 215m<sup>2</sup> të pjesës së parcelës nr. 2669-0, Zona kadastrale, Prishtinë, në pronësi komunale.
- IV. Pikat tjera të Vendimit, nr. 01.463/01-27259/21, dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronë private mbesin të pandryshuara.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 11.02.2021, ka miratuar Vendimin nr. 01.463/01-27259/21, dt. 11.02.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private.

Drejtoria e Pronës, pas pranimit të akteve të vlerësimit nga Ministria e Financave, Departamenti i Vlerësimit, ku parcela nr. 996-0, me sipërfaqe prej 215m<sup>2</sup>, Zona kadatsrale Matiçan, Prishtinë, pronë e Besnik Lecit, nuk e mbulon sip. prej 215 m<sup>2</sup>, të parcelës nr. 2669-0, Zona Kadastrale Prishtinë, pronë e Komunës së Prishtinës.

Besnik Leci ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit për plotësim-ndryshim të kushteve ndërtimore, nr. 05 nr. 350/02-235747/19, dt. 20.05.2021, ku është bërë propozimi për këmbim të parcelave shtesë, parcela nr.997-4, sip.310 m<sup>2</sup> dhe nr. 997-5, sip. 212m<sup>2</sup> ZK Matiçan, në pronësi të Besnik Lecit.

Andaj, sipas propozim-plotësimit për ndryshim, propozohen të shtohen pjesët e parcelave nr. 997-4, sip.310m<sup>2</sup> dhe nr. 997-5, sip. 212m<sup>2</sup>, ZK Matiçan, në pronësi të Besnik Lecit.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet plotësim-ndryshimi i vendimit sipas pikës I të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/03-112364/21, më 16.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

